



VENDIM

Nr. 108, Datë 07.09.2015

**MBI
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E LICENSËS SË
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike dhe nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.09.2015, mbasi shqyrtoi draft – licensën dhe relacionin e përgatitur nga grupi i punes, për miratimin e licensës së prodhimit të energjisë elektrike,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e licensës së prodhimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI**